

VENDIM
Nr. 77, datë 12.3.2026

MBI MIRATIMIN E DISA NDRYSHIMEVE NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s
NR. 302, DATË 17.11.2025, “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘SPITALLA SOLAR’
SHPK NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.3.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 404/1 prot., datë 9.3.2026, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të ERE-s “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Spitalla Solar’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike””,

konstatoi se:

1. Të dhëna mbi shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 302, datë 17.11.2025, ka licencuar shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, me kapacitet të instaluar 90 mw, me vendndodhje në Spitallë, Bashkia Durrës, qarku Durrës, për një afat 30-vjeçar.

- Në pikën 2, të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: “Përpara fillimit të operimit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE marrëveshjen e nënshkruar me shoqërinë ‘Operatori Sistemit të Transmetimit’ (OST) sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes së centralit fotovoltaiik me rrjetin e transmetimit”.

- Gjithashtu, në pikën 5, të vendimit nr. 302/2025, përcaktohet se: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 2, 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”.

2. Korrespondenca dhe dokumentacioni i depozituar nga shoqëria

- ERE ka njoftuar shoqërinë për vendimin e Bordit nr. 302/2025 me shkresën nr. 2403/15 prot., datë 21.11.2025, duke i sjellë në vëmendje dhe plotësimin e kushteve të këtij vendimi.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 404 prot., datë 28.1.2026, shoqëria ka depozituar “Marrëveshjen për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiik Spitalla Solar”, të nënshkruar më 19.1.2026, ndërmjet “OST” sh.a. dhe shoqërisë “Spitalla Solar” sh.p.k.

3. Analiza ligjore dhe vlerësimi

- Me depozitimin nga shoqëria të “Marrëveshjes për lidhjen me rrjetin e transmetimit të parkut fotovoltaiik Spitalla Solar” të nënshkruar me “OST” sh.a., rezulton se është plotësuar kushti i vendosur në pikën 2, të vendimit të ERE-s nr. 302/2015, ndaj kjo pikë e vendimit vlerësohet të shfuqizohet.

4. Nevoja për ndryshimin e vendimit

- Në nenin 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se një akt administrativ mund të ndryshohet, shfuqizohet apo anulohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë për ta nxjerrë atë.

- Në vijim të shfuqizimit të pikës 2, të vendimit nr. 302/2025, vlerësohet i nevojshëm edhe ndryshimi i pikës 5 të këtij vendimi, i cili përcakton se ky vendim është objekt rishikimi nga ERE, duke e riformuluar si vijon: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në vendimin e ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, si vijon:

a) Pika 2, e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, shfuqizohet.

b) Pika 5, e vendimit të ERE-s nr. 302, datë 17.11.2025, ndryshon dhe bëhet: “Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të plotësimit/mosplotësimit të kushteve të vendosura në pikat 3 dhe 4, të këtij vendimi dhe në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi.”.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës të njoftojë shoqërinë “Spitalla Solar” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti